



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 27.6.2025.

Në mbledhje morën pjesë: Nora Kelmendi (VV), Mirsad Vitia (VV), Gëzim Sveçla (VV), Jeta Rafuna (LDK), Milazim Vitija (LDK), Dhurata Jahaj - Retkoceri (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK) dhe Bahri Gashi (AAK).

Munguan: Fehmi Kupina - kryesues i komitetit, Arbnora Berisha (VV) dhe Shegë Beqiri - Badivuku (PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Arbër Sadiki - drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Samir Shahini - drejtor në Drejtori të Arsimit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoja Milazim Vitija - kryesues i mbledhjes (anëtari më i vjetër), me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim-vendim për caktimin e komisioneve për rekrutimin e drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve të institucioneve arsimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;
3. Propozim-vendim për ndërrim të destinimit nga banim individual në institucion arsimor privat;
4. Propozim-vendim për lënje në dëgjim publik të PRRH "Mati 1", blloku A 11;
5. Propozim-vendim për bartje të 45 normave nga cikli i mesëm i lartë në ciklin parafillor dhe fillor;
6. Propozim-vendim për subvencionimin e Ndërmarrjes "Pastrimi";
7. Të ndryshme.

Jeta Rafuna:- propozoi nëse të gjithë anëtarët janë dakord dhe të pajtimit që pika e pestë e rendit të ditës "Propozim-vendimi për bartje të 45 normave nga cikli i mesëm i lartë në ciklin parafillor dhe fillor", të zëvendësohet për diskutim menjëherë pas pikës së dytë të rendit të ditës për këtë mbledhje, për shkak të mbajtjes së testit të arritshmërisë sot në shkolla dhe kohës së limitur të drejtorit të arsimit.

Nora Kelmendi: - tha se drejtori i arsimit, pikën e rendit të ditës e ka propozuar në mbledhjet e kaluara, prandaj po besoj se nuk është e nevojshme të përsëritet prapë e njëjtë.

Leutrim Retkoceri: - i theksoi drejtorit prapë se nga hera e kaluar ka kërkuar disa sqarime në lidhje me vendimin, prandaj opinionet e marra nga Zyra ligjore, nëse ke mundësi që për seancë të na i sjellësh.

Samir Shahini: - tha se të gjitha sqarimet lidhur me vendimin në fjalë, i kemi përcjell tek kryesuesi, por në rast se nuk janë përcjellë te ju, do ta kërkoj atë, në mënyr që t'i keni edhe ju të njëjtat.

Bahri Gashi: - tha se edhe unë në mbledhjet e kaluara kam kërkuar që të na sigurohen informacione shtesë lidhur me pikën “Propozim-vendim për ndërrim të destinimit nga banim individual në institucion arsimor privat”.

Arbër Sadiki: - tha se unë i kam përcjell të gjitha materialet në zyrë të Kuvendit, por nuk e di të njëjtat a janë përcjell edhe te ju.

Pika e parë, Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa, kalon me miratimin e të gjithë anëtarëve prezent.

Pika e dytë, Propozim-vendimi për caktimin e komisioneve për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve arsimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

Leutrim Retkoceri: - tha se na veç u dakorduam për lirimin e drejtorit nga mbledhja, kjo është edhe më e arsyeshme që këto pika të janë afër njëra-tjetrës për sqarim, ndërsa për diskutime dhe pytje do të kërkojmë prapë nga drejtori në seancë.

Pika e tretë, Propozim-vendim për ndërrim të destinimit nga banim individual në institucion arsimor privat.

Arbër Sadiki: - kërkoi edhe njëherë të informohet nga anëtarët e komitetit, lidhur me materialin për pikën e lartëcekur, a e keni pranuar materialin e kërkuar nga Sektori i Kuvendit?

Nora Kelmendi: - i deklaroi drejtorit duke pohuar se i kemi pranuar materialet e kërkuara.

Pika e katërt, Propozim-vendim për lënie në dëgjim publik të PRRH “Mati 1”, blloku A 11”.

Leutrim Retkoceri: - diskutoi për planet rregulluese të hollësishme dhe shqetësimet që lidhen me kohën dhe mënyrën e zbatimit të tyre, sidomos në periudhën e zgjedhjeve. Ai theksoi se është problematike të vazhdohet me përfundimin e planeve rregulluese gjatë fushatës, pasi kjo krijon dyshime për përdorim politik. Retkoceri kërkoi një qartësi në vizionin dhe logjikën e planeve, duke përmendur edhe peticionin për këmbimin e pronave, nga grupi inicues “Kodra e trimave po bëhet”, i cili duhet të trajtohet në kohë, pasi ligji ka afate të qarta.

Arbër Sadiki: - tha se lidhur me Propozim-vendimin për lënien në diskutim publik të Planit "Mati 1" bllikut A11, unë e kam përgatitur vendimin shumë kohë më herët dhe kam kërkuar që të sjelljet për shqyrtim në Kuvend, por për shkak të rrethanave dhe protokolleve, nuk ka ndodh që i njëjti të jetë pjesë e rendeve të ditës. Sadiki shtoi se lidhur me këtë vendim nuk ka ndonjë hartim apo diçka të re, pasi që në aspektin teknik ka disa muaj që është mbyllur si plan. Ajo se çfarë kërkojmë është që të vëhet në diskutim publik dhe pas afatit prej 30 ditësh, të sillet prapë në Kuvend për miratim.

Pika e pestë, Propozim-vendim për bartje të 45 normave nga cikli i mesëm i lartë në ciklin parafillor dhe fillor, e diskutuar në fillim të mbledhjes për shkak të lirimit nga mbledhja të drejtorit të arsimit.

Pika e gjashtë, Propozim-vendim për subvencionimin e Ndërmarrjes "Pastrimi".

Gëzim Sveçla: - pyeti se kush është propozuesi i kësaj pike? Ai vazhdoi me pyetjet se nga marrëveshja e fundit në mes të Komunës së Prishtinës dhe Ndërmarrjes "Pastrimi", a keni informata se a janë bartur mjetet e inkasuara?

Jeta Rafuna: - tha se nuk kam përgjigje, por kjo ka qenë pikë e propozuar nga mbledhja e kaluar para se të arrihet marrëveshja në mes të Komunës së Prishtinës dhe Ndërmarrjes "Pastrimi", por besoj se do të marrim informata shtesë në seancën e Kuvendit.

Leutrim Retkoceri: - tha se do të ishte mirë që të kemi një sqarim më të plotë për gjendjen financiare nga drejtoresha e financave.

Pika e shtatë, Të ndryshme.

Nora Kelmendi: - tha se a ka mundësi gjatë seancës, Kryetari me na tregu çka ka ndodh me komisionin për banorët e "Bregut të Diellit", a është mbledh komisioni, a janë takuar dhe a kanë marrë ndonjë vendim?

Kryesuesi i mbledhjes, pas përfundimit të diskutimeve e konstatoi të mbyllur mbledhjen e gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja mbaroi në orën 10:30.

**Procesmbajtësi
Arton Brahimi**

**Kryesues i Komitetit
Fehmi Kupina**

